Kush eshte tjetër pervec nenes
Qe te jep dashurin e zemres
Neper breza shkon mbas kenges
Shkon e bija mbas te jemes

DIKTATATURA E KADARES

Lule mos me prek
Te kishte Partija
Te deshi Enveri
Te mbroj Qeverija

Neper bote te shkj jeta
Kopenhag, Moske e Paris
Se nuk vuajte nga kuleta
Kishe leket e Shqiperis

Kur ishe ne mosh te re
Dalloheshe per besnikri
Sot qe je ne mosh te vjeter
Po shkelqen per hipokrizi

Ti ke qen shkrimtar I madh
Kur te trajtonte Partija
Sot je nje shqiptar I vogel
Ku lulezon demokracija

Ti ngrite ne qiell Migjenin
Per autopsin e monarkis
Ne Tiran ne gjunje ju ule
Trashgimtarit te monarkis

Partizanet derdhen gjakun
Dhe na prun ne lirin
“Sishte firem po vetetim
Ajo qe nenshkroj stuhin”

Fshatari I lodhur nga draperi
Dhe nuk kish as nje pik dhall
Ti me haje pace gjarperi
Ne Paris vije verdall

Kur puntori ne uzin
Punonte dhe turni I tret
Ti bridhje me limuzin
Neper Franc ne qejf te vet

Sic thot dhe Dritero Agolli
Ti ke ber jete si shkrimtar
Rofte Partija qe te mbolli
Dhe te riti si lastar

Kur ne lepinim buzet
Ty te dham gjith tepsin
Kur ne ta kishim nevojen
Ti si lopa derdhe kusin

Ku na ishe ti Adam
Kur na prun demokracin
Si Konica ne Amerik
Volle vrer per Shqiperin

Ti shkove si refugjat
Dhe mohove memedhesin
E ktheve gurin ne balt
Te ndryshoje historin

Gjithata qe te mbajn anen
Jan servil e kalemxhinj
Jane ata qe shurojn lanen
Edhe shkruajn si qoftexhinj

Gjirokastra ne mendime
Se kush I ka ber magji
Ty te thot shkruaj nga larg
Enver Hoxhen mban ne gji

Ismail ku e ke hallin
Moshen mos e ver siklet
Mos u bej shoku I djallit
Se turpi ngelet per jet

Se mohon dot historin
Shkruan si grek per dinakrin
Ke ne gjak hipokrizin
E ke mekat per pleqerin

Mos na fol si prej olimpi
Se nuk je koka e Zeusit
Nuk je me si ai I pari
Je si myshk ne fund te pusit

ISMAILI I DEMOKRACIS

Ismail zure cmendimin
Shave Marksini dhe Leninin
Mburre Duce Musolinin
Qe hapi vare per njerzimin

Ke akoma per te shar
Aleksander dhe Jul Cezar
Qe pushtuan Boten mbar
Pa te pyetur ty me par

Qendro large nga Enveri
Se ai ishte si ylberi
Shqiperin nxori nga ferri
Ne cdo male u ndez feneri

Pa kujto c.ke shkruar me par
Per Enver Hoxhen komisar
Per Partin flake e zjar
Per ata trimat e par

Tridhjet vjet ci pate fat
Shkelqeve permby asphalt
Tridhjet vjet ne lluce e balt
Ismail o refugjat

Ika dhe une ne kurbet
Koker leku ne kulet
Rugeve ngela si ne mesjet
Nga kjo demokraci e shkret

Shume large nga tyja vajta
Ne Amerike une lava pjata
Punova me ore te gjata
Me buke e shkoll femijet I mbajta

Ne cdo vende ku une punova
Shqiperin nuk e harova
Shume vargje per te I shkrova
Ne cdo vend ku une punova

Ketu large ne megrim
Poezite pa mbarim
Shkrova une per vendin tim
Derdha lot me permallim

Cfar ke shkruar nuk e mohj
Para 90 une do ta mbroi
Koha vete do ta tregoi
Historija do te shkroj

Kur kish nevoj Shqiperija
Ti u largove nga vegjelija
Shkove ku eshte aristokracija
Se vuajte nga burrerija

Ti me pare ke qen dikushi
Sot je kethyer ne askushi
Se vete fajin e ka pellushi
Sistemi xhepat ja mbushi

Thuaj dy fjale per Shqiperin
Po ja ndryshojne historin
Se ballistat prap po vin
Me leke kan bler qeverin

<Sish firem po vetetim
Ajo qe nenshkoj historin>
Ate firem sot e fshin
Edi Rama me partin

Ismail zgjohu nga gjumi
Se Shqiperin e mori lumi
Ti ke qene drejtus forumi
Mos u bej si Faik merhumi

Si u rite ti normal
Ne nje vend anormal
Dije shkruaje per ideal
Sot na flet si I perdal

Si shkrimtar nuk te arrij dot
Je I madhe ne kete bot
Me vjen qe te qaj me lot
Se e le Shqiperin pa zot

Se nga ty une u frymezova
Kudo qe vajta dhe punova
Vargjet e tua une I kendova
Dhe per to une u betova

Nuk po shkruaj nga xhelozija
Po me dhimset Shqiperija
Se kaq jane mundesit e mija
Ty te kishim si Perndija

Vepra jote nuk mohoet
Neper shekuj do kujtohet
Neper breza do lartsohet
E verteta do te rishkrohet

Tridhjet vjet me demokracin
S'the nje fjale per Shqiperin
Qe e prene dhe e grin
Ata qe u ben zengjin

Ti o djali I Gjirokastres
U dogje si flake e kashtes
Nuke I dhe ndricim nates
Harove dhe zjarin e vatres

Nuk te shaj dot si shkrimtar
Se ke qene si Yll polar
Po I vogel si Shqiptar
Hodhe hirin larte mbi zjar

Kur isha I ri ti me edukove
Tani qe u plaka, ti me helmove
Te gjith librat I riprovove
Dhe permbajtjet ja u ndryshove

Kur isha i rri ti me edukove
Tani qe po plakem, ti me helmove
Te gjitha librat i ripunove
Dhe permbatjet jua ndryshove

<<Ku ti kerkoh renjet e tua parti>>
Kendoheshin me shum nostalgji
Nga te gjith njerzit, pleq dhe femij
Para se te largeshe i fshive me shami

CIZE ARIFI "XHAXHAI IM"

Nga Haderajt ne mosh te re
Dole si shqiponje mbi re
Luftove per nje bote te re
Jeten e dhe ne mosh te re

Njezet vjec ne lule te rinis
Ne balle yllin e liris
I dhe gjakun Shqiperis
U vrave prej tradhesis

Jeten tende se gezove
As familje dot s'krijove
Per Shqiperin u flijove
Koken lart nuk u dorzove

Lajme e urdhera me shum vler
Nga brigata e peste si korier
I shperndaje si skifter
Neper shi dhe neper er

Fale jeten dhe rinin
Derdhe gjakun per Shqiperin
Nuke duroje dote roberin
Enderove vec lirin

Po lirin ti se gezove
Gjakun tende ti e dhurove
Ballista e gjerman poshtrove
Para plumbit su dorzove

Po ballistat si zojte e sorres
U mblodhen te sheshi I Vlores
Te qelluan me armen e dores
Mu ne ballet te harku kurores

Ty nuk te gjente dot gjermani
Po te spijunoji ballist shejtani
Se I ngelesh boshe sehani
Zoraxhinjte e ketij vatani

Cize Arifi xhaxhaji im
Ishte djale me shum guxim
Jeten e tije e beri flijim
Kur s'kishe par as nje gezim

Ata qe ty te pushkatuan
Nga demokracija u nderuan
Pasi vodhen dhe u pasuruan
Gjakun e deshmoreve e mohuan

Historija per ju do te shkruaji
As nje her nuk do tu haroji
Ishte I paster gjaku I juaji
Nuk pranuat roberin e huaji

Cdo mengjez nga gjumi zgjohem
Ne cdo kohe per ty krenohem
Per gjakun tende une betohem
Per Shqiperin do te flijohem

Kush jep jeten per Shqiperin
Dhe derdh gjakun per lirin
Da nderojne brezat qe vin
Do mburen me historin

ATA QE NUK VDESIN KURR

Ata qe nuk vdesin kur
Eshte e shkruar me prokur
Do qendrojne perher flamur
Jane gedhendur ne cdo mur

Kalojne shekuj e mijvjecar
Ata ndrijne si yll polar
Vepra e tyre e lar ne ar
Ndricon naten dhe ne sirtar

Kush tjeter vec poetit
Qendron lart mbi valet e detit
Nuk I tremben as termetit
Ndricojne historit e shtetit

Shpirt human eshte poeti
Zemer gjer sa I gjith deti
Fjale embel si sherbeti
Ne cdo kohe e do mileti

Ka patur dhe ka shkrimtar
Me uji floriri jan te lar
Jan te vjeter mijevjec
Hiri tyre flake e zjar

Shkrimtari dhe poeti
Jane te dy si vale deti
Te terheqin si magneti
Respektohen nga mileti

Homeri qendron I pari
Me Iliaden si fanari
Historin mbi pllaka vari
E skaliti si argjendari

Eskili dhe Sofokliu
Europidi me I riu
Qe te kater race gjeniu
Nderi I tokes qe I mbiu

Dhe Romaket per Virgjilin
Llambes I ndezen fitilin
Botes se ci dhan ndricimin
Virgjili zbukuroj shkrimin

Shekspiri me pene ne dor
Shkruajti tragjedit horror
Ne oborin mbreteror
Vritet mbreti per kuror

C'far te them per Viktor Hygon
Per te mjeret ai mendon
E mer penen edhe shkruan
Dhe me fjale te pervelon

Dhe shkrintari Xhek London
Ameriken gjith nderon
Martin Iden kur lexon
Mendje e zemer te fluturon

Shkruajti Bajroni per Shqiperin
Shkruajti vargje per vegjelin
Ngriti larte trimerin
Riti nderin per Anglin

Edhe vepra e Leon Tolstoit
Shkruar me penden e palloit
Rodhi si ujte e perroit
Me I miri gjith soit

Ishte Ana Karenina
Qe u hodhe si gjeraqina
Poshte trenit lart mbi shina
Ngeli veper neper vitrina

Si Pushkini me Esenin
Qe e nderuan letersin
Shkruajten vargje per njerzin
Do tua dim gjithmon mirsin

Nuk harohet Omer Kajani
As Sadiu nga Irani
Rubairat dhe gjylystani
Do te rojn sa vet vatani

Si poeti dhe shkrimtari
Qe kane hipur te altari
Zemra u digjet si zjari
Nuk u shuhen as te vari

Dhe ata qe jane Shqipetar
Kan ndricuar si fanar
Ne cdo vend ku ndezen zjar
Dhe nga hiri nxoren lastar

Me I madhi si Atdhetar
Naim Frasheri si shkrimtar
Na nderoji si Shqipetar
Shkruajti vargje mbi altar

Po Migjeni I mjerimit
Mori emerin e pagezimit
Sipas vlerave te shkrimit
Leshoji thirjen e kushtrimit

Agolli me Kadaren
Fan Noli me Migjen
Lasgushi me Asdren
Ne Tomor ngriten folen

Nasho Jorgaqi si eseist
Shkruan vargje si filozofist
Dallohet si analist
Eshte me bindje ateist

Ka te tjer qe s'po I them
Po une vete ku do jem
Ti qe me do hajde gjem
Qe te dy ne hene te vem

O sa pak ka ne kete bot
Poet ,shkrimtar e patrijot
Qe vargjet I shkruajn me lot
Po Boten se ndryshuan dot

Poeti si melodi e kenges
Shkrimtari si ninulla e nenes
Qe te dy si drita e henes
Ndalojne te rahurat e zemres

Si meteor ndricon poeti
Shkrimtari te trondit si termeti
Ne gjunje u ulet dhe vet Mbreti
Detyrohet me shum nga sikleti

Lume ata qe s'do harohen
Neper vite do lexohen
Jo te gjithë do kujtohen
Vetem ata qe do dallohen

QENI BESNIK

Ma tregoj Ali Vasiari
Historin e nje fshatari
Andej thelle nga Skrapari
Per nje qen plasi se qari

Ngjarja nis me nje udhetim
I zoti me gjith ngurim
Mori qenin per shoqerim
Per tu dukur pak me trim

Ruga e gjat te ben te lodhur
U ulen per tu cplodhur
Mendja e tije e kudo ndodhur
Mendonte per grurin e korur

U ngrite dhe iku si bleta
Nga xhepi I ra kuleta
Nuk ja pan dot syt e shkreta
Nxitonte per punet e veta

I zoti qe po shpejtonte
Qenin dot spo e kuptonte
Qe se linte te kalonte
S' kethehu as koken te shikonte

Qeni qe e pa kuletën
Syte te ajo I mbeten
Lehente forte per te shkretën
Se thosh dot te vertetën

Qeni lehte I zemeruar
Kuletën per te treguar
I zoti qe e kish rezuar
Koken s'kthente per ta shikuar

Mendoj qenin te terbuar
Qe se linte per te shkuar
Me nje plumb e kish qelluar
Dhe ne zemer I dritheruar

Vazhdoj rugen I menduar
Thell ne shpirt I helmuar
Per qenin qe kish asgjesuar
Qe aq mire e kish kaluar

Vazhdoj rugen I ziu fshatar
I shkoj mendja per nje cigar
Futi dore nen astar
Kuletën se kish si me par

U kujtua ku kish qen ulur
U kethye me koke perkulur
Kalin shpejt me te versulur
Vete mbi kal duke tundur

C'te shikoj fshatari I shkret
Qeni koken mbi kulet
Zvar ish hequr me siklet
E mbronte si pronen e vet

U pendua qe e kish qelluar
Kish menduar se ish terbuar
Qeni ish besnik I zgjuar
Te zotin e kish nderuar

Qau dite e qau net
Qante per qenin e shkret
Qe se pati dot kismet
Po e vrau me doren e vet

Qeni eshte shum besnik
Do trajtuar si shok e mik
Per gjith naten ne ciflik
Ruan te zotin nga cdo armik

KURBETI

Qan nena , qane femija
Iku babai nga shtepija
E mori kurbet mavrija
Bashke me jeten e tija

O kurbet more kurbet
Ndave djemt nga nena e vet
Qe I riti me shum siklet
Tani qane me syt nga ret

Lajmin solli gjitonija
Ne gjith fshatin u hap zija
Qane babai dialin e tija
Qe su kthye me te shtepia

O kurbet more kurbet
Ndave njerzit ngakjo jet
Secili ne hall te vet
Pa nje leke ne kulet

Bota s'ka gjetur sherim
Jeta eshte lote e gezim
Duhet patur shum durim
Te mos kalosh ne trishtim

Shkaku eshte ekonomija
Se nuke punon qeverija
Falen cdo dite te xhamija
Populli vuane nga urija

Nuk ka faje vetem kurbeti
Fajin e ka edhe vete shteti
Pushtetaret njelloj si mbreti
E nxjerin florin nga deti

Cdo njeri ka hallet e tija
Nuk e mban dot as shtepija
I del mendja nga catija
Se e detyron vet varferija

O kurbet I qar me lot
Cove njerzit ne ate bot
Ishin njerz me mendje plot
Edhe endrat si pane dot

Kurbeti shoke kurbeti
Iku Djali nga sikleti
Atje vate atje mbeti
Nuke u kthye dot I shkreti

O kurbet kurbet mavrija
Ndave njerzit nga njerzija
Ndave babain nga femija
Rane tjegullat nga catija

Pse kjo bote me kaq trishtim
Kurbeti nuk paska mbarim
Neper shekuj ne rugetim
Rinis jeta me mundim

Qane femija per baban
Qane me lot e te djeg xhan
Dhe per dore e kap maman
Se nuke kane buke te han

Neper shekuj vjene kurbeti
Plage e vjeter eshte I shkreti
Fukarain e la shendeti
Vetem kripen mer nga deti

Te ngrihet ne kembe vegjelija
Te vendoset barazija
Te zbatohet drejtesija
Qe te shpetoji gjith njerzija

Ne kurbet iket nga halli
Koka pas se te mer malli
Te dhemb koka te djeg balli
Ndashesh nga njerzit per se gjalli

Plage e vjeter mbas <Nizamit>
Eshte ky kurbeti I shejtanit
Largon njerzit prej vatanit
Larg detit pertej oqeanit

VAJZA E VALEVE

Kjo ka ndodhur ne Himar
Kushedi sa vite me par
Anes Detit duke qar
Priste vajza nje mergimtar

Sic thot dhe Cajupi I shkreti
Te vertetat dot si gjeti
Ikin large te kurbeti
<Kush vajti dhe nuk mbeti>

Vajza na kish qene jetime
Nuk kish pare kurr gezime
Ne zemer vetem hidherime
Koha mbushur me zhgenjime

Ti moj vajze bije e Himares
U hodhe persiper vales
Doje djalin e mehalles
Qe u zhduk si kalliri I fares

Kaluan dite e kaluan net
Koha iku me shum siklet
Ti e bere punen e vet
U hodhe me koke ne det

U tuned toka si nga termeti
Ne funde te ujit u be qameti
Ti u ketheve ne sirene deti
U trondite gjith mileti

Ti moj vase e valeve
Si shqiponje e maleve
Dhe bilbili I brigjeve
Je jehona e kengeve

Cdo mengjez me shpres ti shkove
Emrin permbe rere e shkrove
Me ne funde dot s'durove
Edhe mendjen shpejt e mblodhe

Kaluan muaj e kaluan vite
Akoma djali s'po vinte
Nate e dite gjum po flinte
Apo me nje tjeter rinte

Ti kete se gjeje dot
Te vajti mundimi kot
Nate e dite qave me lot
Vendose te ndryshoje bot

Qaje dite e qaje net
Qaje ti me lote te nxeht
Per djalin qe doje vet
Qe te iku ne kurbet

Zbathur ikje anes zallit
Te pikonte djers e ballit
Tu zhurit zemra prej mallit
Per ato dy buzet e djalit

PLEQERISHTE

U thinja shoke u thinja
S'me ze gjumi me dhemb brinja
Ju s'besoni se eshte e imja
Prisni sa tu zbardhet qimja

Kur vajta ne mosh te shkuar
S'kisha dhembe per te kafshuar
Vetem duar per te ferkuar
Edhe sy te zgurdulluar

Nje nga nje me iken vitet
Tensioni gjakut po me ritet
Temperatura nuk me zbrietet
Vdekja anes me vertitet

I semur isha me ilace
Plaka me bente kulace
Cdo mengjes kulac e pace
Raki pija me kanace

Me ka zen e shume meraku
Kame ca dridhje si prej plaku
Ka filluar me dhembe stomaku
Nga dora me bje sapllaku

Kjo pleqeri e flamosur
Kembe e dore te sakatosur
Edhe huqet s'kan te sosur
Dua vete per te varosur

Pse keshtu pleqeri e shkret
Kam qen djale me lezet
Edhe burre per muabet
Rija gjithmon ne qoshet

Muabetet I tirja holl
Se kam patur dy gram shkoll
Edhe tymi me shkonte fjoll
Nuk kame qen si keta pinjoll

Ce gjeti te shkretin plak
Rinte ulur mbi oxhak
Nga syte po dilte flak
Pinte raki me bardhak

Edhe gjunjet po me dridhen
Kembe e dore s'po me binden
Pantallonat s'po me lidhen
Dhe kepuçet s'po me zgjidhen

Duart me dridhen nga pleqeria
Me vjen anes gjithë shtëpia
Syte I mbaja te tepsija
Pres si kali te vij tagijja

Me shpetoj e shkreta shurr
Nuk e zgjidh dot oshkur
Se nuk jam me per burr
Po jame nje plak I semur

Plaka ime si ziliqare
Une e mbaj si kanakare
Me ri mbrapa si manare
Kur vjen puna s'ma var fare

Hajde plake meru me mua
Te kam dashur dhe te dua
Ti dhe une mish e thua
Une te prek ti thua sdua

Jame I lodhur i drobitur
As nje here s'me ke sajdisur
Si gjithmon je koke krisur
Me kerkon te rri stolisur

Ah moj plake lozonjare
Je e bukur dhe tinzare
Mendja po me iken fare
Si tja bej nuk kam as pare

Ah kjo koha shume barbare
Iku shpejte se shijova fare
Hapja syte ne dritare
Mendja me kish ikur fare

Plake moj mu derdh kafeja
Me ra nga dora xhezveja
Mos shiko nga penxhereja
Si ato nuset e reja

Une ketu jame ne siklet
Ti me rri me ben tualet
Hajde ketu me bej ysmet
Se me von do te bej lanet

Po une prap si zemerohem
Se naten me te do ngrohem
Ne krahet e saj do te shterngohem
Sa te digjem te pervelohem

Te kam dashur dhe te dua
Se te kame si koker ftua
Une me ty dhe ti me mua
Jeta jone eshte burre e grua

Ti moj pleqeri e shkret
Hoqe hallet me siklet
Edhe large ne kurbet
Mendon per vendin e vet

Pleqeri halle me derte
Ke kaluar shune siklete
Nuk mendove kur per vete
Me sy mbyllur rugen gjete

Pleqeri moje pleqeri
Kur kame qen djal I ri
Nate e dite me cuperi
Tani dhe plaka me mban meri

Kur isha ne moshen e rinis
Verdall I bija Shqiperis
Ne dark te dera e shtepis
Ne menjgjes te pylli me qeparis

Me mbyste era e lumturis
Se kisha moshen e dashuris
Tani me mbyti avulli I rakis
Po percjell vitet e pleqeris

Zemera me eshte ber sakate
S'ngjitem dote neper kate
Kur dikur beja mekate
Bashke me vajzat arakate

Po degjoj kembor dhe zile
Me duken ma kan me hile
Duan te me cojn ne azile
Apo ma bejn mua kastile

Pse keshtu more te shkret
Ketu do te vini dhe vet
Nuk do shkoni gjithmon perpjet
Do te zbrisni dhe ju tatepjet

Se punova per te tjer
U dhash buke ,uji e sheqer
Dhe tani s'ma din per nder
S'me vlersojn as nje her

E kame madhesin e zemres
Si dhurat nga ana e nenes
Prandaj ja mar gjithmon kenges
Gjer sa te me vij momenti lemzes

E ndjei veten te lenduar
Shume here ju kame kerkuar
As nje here nuk me jan afruar
Zemeren time e kan coptuar

Rojta shume ne kete jet
Nuk mbaj mend c'kam ber as vet
Vec per vitet ne kurbet
Kujtoji femrat me respect

Kalojne muajt e plotesojin vitin
Vitetet riten dhe ditet ikin
Gjunjet shkallet dot si ngjitin
Plakun e shkret e merzitin

Hapte syte dhe shikonte
Nga faqja lote leshonte
As njeri nuke e degjonte
Nga inati pordhe leshonte

Shaja veten nga inati
Se me kish lene takati
Iku koha shkoji e vati
Mua me kish ngel sehati

Edhe xhepat I kam te shpuar
Nuk kam lek per te nemuruar
Te gjith njerzit me jan larguar
Vetem vdekja me eshte afruar

Me trete pleqeri me trete
Kaloji vite plot siklete
Kur ishe koha per salltanete
Nuk mendova kur per vete

Iku koha shkoji e vate
Me del gjumi mbas mes nate
I nderroji nja dy krevate
Me mua pleqeri cfar pate

I mbushur plot me maras
Vendosa qe veten ta vras
Fjale e lige le te bucas
Keq me vjen c'do le pas

Me raki do ta djege shpirtin
Gjith prapesit le te ikin
Me te mua s'kan cfar ngjitin
Se une e kame prer shiriten

Me vjen keq qe do ndahem nga kjo
bot
Se kishe te mira dhe te liga plot
Per te gjitha kame qare me ze e me
lot
Por ne funde u dilja te gjithave zot

Qaje me lote per Kohen e shkuar
Iku shpejte e pa kuptuar
Vone e nisa me te shkruar
Jeta ime do treguar

C'bera dije c'po bej sot
Kendova me ze te plot
Sot as kembet s'leviz dot
Per te shkuaren qaj me lot

Kur vjen fundi I pleqeris
Shuhen flaket e shkendis
Ndizet llamba e xhelozis
Qe lajmeron ardhjen e zis

Cpate plake qe me ike
Ike ne atmosfer kozmike
Mua dritat pse mi fike
Dergom ca rreze elektrike

Sa e kisha plaken gjall
Nuk mbaj ment te kisha hall
Cdo gje e bluaja nen dhemball
Tundej e gjith nje mehall

Tani qe une vetem mbeta
Nuke ka leke as kuleta
U mendova shpejt e gjeta
Po me pret plaka e shkreta

Se une larte do te ngjitem
Ne ate bote kurre s'te shqitem
Dhe me thike le te pritem
Me ne toke pa ty nuk zbritem

JETA IME

Do mar bllokun ne sepete
Do ti shkruaj dy fjal per vet
Do ti mbledh te shkretat derte
Do ti hedhte larte mbi vete

Po e nise nga feminija
Sa kane ruajtur ment e mija
Qe kur luaja te avllija
Gjer sa ika nga shtepija

Ne fshat u linda ne qytet u rita
Pemen qe mbolla vete e selita
Per cdo vite deget krahesita
Me djersen e ballit renjet vadita

Kudo qe vajta kudo qe shkoja
Nje fjale te lig nuk nxora nga goja
Me te mencurit gjithmon degjoja
Dhe te ligun kur se pergojoja

Qe I vogel dhe I pa ritur
Koken larte mbaja te ngritur
Fizikishte dhe I kalitur
Djal fshati I skalitur

Nga natyra kam qen I mbar
Spara beja shum zarar
S'kame qene kur ziliqar
S'kam ber njeri per te qar

Kam punuar dhe rojtur me nder
Me djersen e ballit jam ushqyer
Problem s'kam pasur as nje her
Punes ja kam ditur vler

Se im vella iku jashte shtetit
Me misione pertej detit
Se ishte besnik I shtetit
Ngela vetem rugeve te qytetit

Shkollen vazhdova mbasdite
Dhimbje kokes shpesh me zinte
Sedra ime nuk me linte
Neper endra larg me shpinte

Kur kame qene djal i ri
Jame mar dhe me dashuri
Shkoja nga jugu ne veri
Si gjeologu per flori

Tani qe po plakem vec eren kerkoj
Larte e poshte ngado qe shkoj
Ne cdo kohe syte zgurdulloj
Per te shkuaren shpesh lotoj

Ne aksione si vullnetar
Une dilja gjithmon I par
Para shokeve ndizja zjar
Per te shkuaren jam krenar

Sipaskohes si komisar
Ne parti si sekretar
Shume I ri e ndeza zjar
U dallova si revolucionar

Librin kam pas shoke ne jet
Kam lexuar dite dhe net
Se kame pasur shum vullnet
E tregojn dhe shkrimet vet

Librit nuk ju ndava kur
Lexoja si I semur
Si dy shok me prokur
Hodhem themelet mbi gur

Si peshku qe fle te lumi
Mbi libra me zinte gjumi
Me gjalleronin si sorumi
Dilnin endrat nga bodrumi

Me deshir dhe me vullnet
Arita te shkruaj dhe vet
Ne nje mosh me siklet
Kisha kaluar mbi pesdhjet

Librin e gjasht qe po levroj
Shum shpejt do ta mbaroj
Mua shume do me gezoj
Kur lexuesi dota vlersoj

Se libri te jepe horizont
Kush lexon e ka mendjen plot
Dhe mer vesh cfar ka ne bot
Nuk te shkon mundimi kot

Ne socializem u linda dhe u rita
Prej baltes ne kembe u ngrita
Ne rugen e veshtir nuk reshqita
Qellimet e mija vete I arita

Koha qe erdhi sistemin ndryshoj
Nje epidemic vendin e pershkoj
Njerzit nga puna I pushoj
Se terapija nga e para do filloj

Neper viteshum punova
Djersen lume e kullova
Erdhi ora qe dhash prova
Per te vjedhur nuk pranova

Ashtu si ben shum te tjer
Ne demokracin e perzier
Vodhen pasurin me vler
Shqiperine e hodh ne er

Padrejtesit une sfidova
Ne ideal besnik qendrova
Dhe moralin fort shterngova
Dhe femijeve jua trashgova

Syte me lot ,koken menjan
Ikem dhe e lame Vatan
Me avjon permbi oqean
Fluturuam neper tufan

Mbrapa globit na coj fati
Se ashtu erdhi sehati
Ne Shqiperi u ngjall lugati
Ulurinte nga inati

I vuri flaken Atdheut
Ringjalli krimbat e plehut
Qe flinin te varri I beut
I vuri ne ballet e kreut

Shume te tjer si puna ime
U larguan me mallengjime
Me zemren cope e therime
Ngelen si vajzat jetime

I veshtire ishte fillimi
Ne kohe te ndryshme behej zgjimi
S'te shkon mendja te argetimi
Me pare do fituar besimi

Punoja nga dy- tre pun
Nga e djela ne te shtun
Se hallet qe na zun
S'na linin te flinim gjum

E fillova me te lar pjata
Pastaj shkova ne pune te larta
Ne cdo vend suksese pata
Duar dhe mendje kisha te arta

Ne uzina kimike ne vendin tim
Ne fabrika mekanike ne mergim
Gjithmon kam qen me perkushtim
Se kam punuar pa pertim

Pronaret kudo qe vajta
Me mbulonin me levdata
Punoja me ore te gjata
Jepja rendimente te larta

Vepra ime me e nderuar
Femijet e mi jan te shkolluar
Dhe me grad ate arsimuar
Pune te larta kan filluar

Se I rita dhe I mesova
Dhe me pune I edukova
Bashk me ta jeten ndertova
Dhe si prind u gezova

Punova e rojta me nder
Dhash kontribut me vler
Su kurseva as nje her
Qe nga dita qe kam ler

Eshte e thjeshte jeta ime
Kam patur dhe ca mundime
Po me shume kisha gezime
Kam aritur shume qellime

Kohen kur linda e mesova
Ditelindje ne cdo vend e shkrova
Jeten si me erdhi e jetova
Emerin tim e zbukurova

Ne fshat u linda ne qytet u rita
Vite me von ne kurbet mbrita
Nga e para jeten e ringrita
Me mundime te mirat I arita

As nje her problem per shoqerin
Nderim te vecant per miqesin
Permbys e ketheja shtepin
Ne zemer kisha miresin

Nuk kam pasur mekate mbi vete
S'kam ber as jet me salltanete
Ndonje leke e fusja dhe ne sepete
Mendoja per femijet dhe per vete

I perjetshem nuk do te mbes
Do vi dita dhe do te vdes
Te mirat do ti le ne nje thes
Te keqijat do ti fshij me fshes

Se puna kur nis per te car
Te ngrys gjeneral e gedhin ushtar
Qe te dalesh gjithmon I lar
Do ven gjoksi punes me par

Mall o mall u pervelova
Per Shqiperin u permallova
Koken larte kudo qe shkova
As nje here nuk e harova

Edhe vete nuk e besova
Ne cdo kohe besnik qendrova
Idealin nuk e ndryshova
Fort ne zemer e shterngova

Boten brodha ne cdo an
Shume kam par dhe pak me pan
Malli qe kam per Vatan
Ma dogji te shkretin xhan

Large Atdheut ne mergim
Kaloj Kohen me trishtim
Cdo mengjez kur bej zgjim
Lote me venin me permallim

E brodha te shkreten bot
Nuk paska si vendi jot
Per ate vend po qaje me lot
Se me iku mundimi kot

Tani qe ja mora dores
Do hap kutin e pandores
Ashtu si tiktaku I ores
Do punoj ne mes debores

Nuk kam qen I perviligjuar
Po kam qen I per kushtuar
Ne praktik I angazhuar
Ne teori shum I perveluar

Librin kam si pjes te jetes
Kam shkruar sipas te vertetes
Cdo njeri sipas te vetes
Ta gjykoj ne fund te fletes

Shume libra kam lexuar
Biblotekat kam germuar
Nisa dhe vet per te shkruar
Shpirtin tim e kam qetsuar

Pasuri e pa cmuar
Eshte libri I lexuar
Te paret qe kan shkruar
Historit kan levruar

Gjat punes ku une punova
Sy e dore I perqendrova
Mendjen per gje tjeter shfrytezova
Ne cdo kohe per poezit mendova

Nje nga nje vargjet I shkrova
Pes libra une I perfundova
Me te njejten ngarkes vazhdova
Kete ruge une vete e zgjodha

Ne karakter kam ndershemerin
Ne shpirt kam ciltersin
Ne zemer kame dashurin
Ne mendje kam Shqiperin

E kame then diku me par
Nje xhaket pa astar
E kame ruajtur ne sirtar
Da mar me vete ne var

Eshte kujtim nga vendi im
Qe me riti me mundim
Halli me pruri ne megrim
Bera femijet me arsim

Pjese e jetes eshte dhe gruja ime
Eshte e ralle ne perkushtime
Per te kame shum vlersime
Gjithmon pran me perqafime

Per kete grua jam me fat
E kam shok per dite e nat
Si dy zoqe ne shterngat
Fluturuam lart e me lart

Do dal mbi pllaken e varit
Do mbaj besen e idealit
Si bora ne maj te malit
Do tretem ne syt e djalit

Jme krenar per jeten time
Bera pune,bera dhe shkrime
Do ti le pas si kujtime
Cava jeten pa udhezime

Kush punon dhe ron me nder
Eshte njeri me shum vler
Qendron larte mbi te tjer
Qe veten e kan perlyer

Jeta ime eshte moral
Ka ne mes nje ideal
Si bora qe shkrin ne mal
Poshte do futem prap do dal

Kam then gjithmon te verteten
Nuk pranoj ta drehhte fleten
Vlersoj punen jo kuletën
Me nder dua ta mbyll jeten

Ne parim kame ndershmerin
Kame ne gjak besnikrin
Qe kane vlera per njerin
Me te shtrenjte kame lirin

Jeta ime si ylberi
Shkelqeu mbi pllak mermeri
Ne cdo kohe ne vend nderi
Goji embel si sheqeri

Ata qe nuk me duan mua
Le ti nxjerin syt me thua
Se dhe une ata si dua
Mendjen time s'jua jap hua

Do flas e do shkruaj si dua
Se nuk jame lume e perua
Po jame burre zemer dragua
Nuk pranoj te rroj si grua

Nuk mbaj shpres te perendija
I zgjidh vete hallet e mija
Une e di ku pikon catija
Nuk kame frik nga pleqerija

Punen qe kisha passion
Elash e dola ne pension
Syri I majte me loton
Se nuk ka kush me kerkon

50 vjete me mundime
Sec u lodh kjo zemra ime
Po nuk pati shume fitime
Plot me dallge jeta ime

Thash dhe vet sa u gezova
Librin e peste kur mbarova
Ashtu si dita une i shkrova
Te vertetat pasqyrova

Jeta e thjeshte e nje poeti
Qe nuk ka bere jete mbreti
Siper dallgeve doli nga deti
Ta vlersoj vet mileti

EPIGRAME

Nuk jam profeti I profeteve
As kam jetuar ne jet te jeteve
Po midis librave ne mes te fleteve
Mesova sekretin e sekreteve

Nuk jam me I dituri botes
Nuk jam as gjeniu I epokes
Po per te dalluar fundin e gropes
I kame ne vende mente e kokes

Mos me pyet se nga jam
Se te shkruar ne ball e kam
Nga Laberija me shum fam
Barutin me grusht e ham

Miku dhe armiku jot
Nuk jan per mua as dije as sot
Kur per buke une qaja me lot
Ti mi kishe hambaret plot

Kush e mban veten te zgjuar
Pa nje liber te lexuar
S'behet fjal per te shkruar
Ai veten ka mashtruar

Edhe hekuri kur ferkohet
Ne mos keputet hollohet
Ashtu dhe njeriu kur sforcohet
Nga puna e tepert konsumohet

Ne ke qene njeri me vler
Edhe vdekjen e ke me nder
Nuk do harohesh as nje her
Do te kujtojn brezat e tjer

Hidhi hapat sipas hallit
Mos degjo fjalet e djallit
Rro si bleta ne maj te malit
Mos rri si miza ne bisht te kalit

Kush I sherben diellit do ngrohet
Dhe gjithmon do te kujtohet
Kush I sherben djallit do te ftohet
Pergjithmon do te harohet

Mendjen time s'ta jape hua
Se per vete ate e dua
Jame pellumb e jo fajkua
Nuk ti nxjer syte me thua

Mendon mendja pastaj flet gjuha
Nuk ka burre te linde si grua
Nuk shartohet shega me ftua
Nuk hahet supa me pirua

Qeni lehe kur eshte I lidhur
Kali iken kur eshte I zgjidhur
Zeri del me te dridhur
Kur ka dhimbje me te hidhur

Ka te vdekur mes te gjalleve
Qe nuk jane race e te pareve
Po jane rraca e shpellareve
Rin si kali mbas mullareve

Ka te gjalle mes te vdekurve
Qe nuk jan race e te mbetureve
Po qenderojn mbi sojin e mbretereve
Dhe jetojne midis shekujve

Dardha bie ne fund te dardhes
Vazhdon raca sipas fares
Nene e bije sipas radhes
Shkon e dyta mbas te pares

Filxhani le te jete si te doj
Shija e kafes mbetet nje soj
As xhezveja s'ka merit qe e shkumezoj
Eshte dora e njeriut qe e pregatitoj

Uji buke dhe oksigjen
Te natyra vec I gjen
Vetem shkenca te refen
Ne vend tjeter nuk I gjen

Une kame madhesin e zemres
Si dhurat nga ana e nenes
Prandaj ja mare gjithenje kenges
Gjer sa te vije momenti lemzes

Pse kjo bote kaq tinzare
E mban gjarprin ne kamare
Pret te hapet nje dritare
Ti helmoj njerzit per fare

S'jame rigon po jame lis
Nuk ngjan fisi me cdo fis
S'gjan kanguri I Australis
Me ariun polar te Siberis

Nga e thena ne te ber
Eshte ne mes nje mal I ter
Robot prihen me gersher
Pastaj qepen me gjelper

Kush djeg djepin ku eshte tundur
Nga mendja do jete I shkundur
Historis ne gjunje do ulur
Se me gjak ajo eshte thurur

Kush pret degen ku ka hipur
Eshte nga mendja I lajthitur
Mos kerko larte per tu ngjitur
Pa pare rugen per tu zbritur

Ai qe mohon nenen e baban
Ai mohon dhe vete vatan
Dele mbi trup si ciban
E derdh vrerin ne filxhan

Kush shan shokun ose vellan
Per bindjet qe ata kan
Turpin me buk le ta han
Ata vete mendje nuk kan

Dashurija ne pleqeri
Ka me shume alegri
Ka pasijon e nostalgji
Kur dy duart vendos mbi gji

Te iken mendja nga fiqiri
Rron l jati vdes l biri
Digjet druri dhe mbetet hiri
Ndizet flaka shkrin qiriri

Nuk ka vaj po u pre ulliri
Po s'ra shi thahet kalliri
S'vlen kallaj sa vlen floriri
As gjembaci sa lule bliri

S'qendron catija pos qe muri
Edhe gardhi pos qe huri
Kur ka dhimbje cahet guri
Ne gjysem shtize rri flamuri

Kur s'pi sise shteron gjiri
Si babai e pi l biri
Eshte mall nga me l miri
Ne gjunje ulet dhe veziri

Sa me shume koha kalon
E vrteta triumfon
Historin e zbukuron
Personazhin e betonon

Kaposhi kendon pula ben vez
Mos u bej xheloze moj sorre e zez
Pula ben zogj e kaposhi te zgjon
Ty moj sorre e e zez as nje s'te degjon

Jeta e njeriut eshte me vler
Kur punon e jeton me nder
Qe punet dimerit behen ne ver
Per cdo nate ndez nje fener

Per punet e tua mos pyet te tjeret
Nuk ngrihen ne kembe te po saleret
Te pasurit nuk ndihmojn te mjeret
Edhe kafshet s'pyesin per stallieret

Tavolina pa sirtar
Si xhaketa pa astar
Anija pa marinar
Si trupi pa damar

Mos pyesni kush ka qen
Shikoni cfar ju ka len
Cdo njeri nje pune e ben
Punet e mira gjurem len

Thash se ishe baba teqeje
Po ti me dole si mi haleje
Largoheni dreqin prej meje
Se pranon as nje lloj feje

Me radhe vitet rezojn shekullin
Dheu I bute tret dhe hekurin
Milimetrat plotesojn metrin
Vegjelija rezon mbretin

Poezija te jepe pavdeksin
Zemra rrehe per dashurin
Gjaku vlon per trimerin
Eshte e dashur per njerzin

Une nuk shkruaj per fitime
I heq vete ato shpenzime
Shkruajte sipas bindjes time
Koha le tu jape vlersime

TRIPTIKA

Atdheu Nena dhe Fimija
Tre simbole nga njerzija
Brumosur nga miresija
Skalitur te mente e mija

Atdheu zeri I trumpetes
Nena fjala e se vertetes
Femija si gezimi I jetes
Bashke si lulet e buqetes

Nuk me mban dot as shtepija
Po si pata dote te trija
Nuk ka vler as pasurija
Po u fute ne mes ligesija

Kur kame lindur ma treguan
Ata vete qe me krijuan
Aq sa dinin me mesuan
As nje her nuk me lenduan

Kur do vdes kush do ma tregoj
As njeri s'ta thot me goj
Se dhe vdekja s'eshte njelloj
Vjene e iken kur te doj

Ndonjeher te ben hatan
S'te mer tyja te mer evlan
Te djeg shpirt e te djeg xhan
Te le vetem ne ter dynjan

Plot me halle esht kjo bot
Mundohesh e si zgjidh dot
Se te dalin te tjera plot
Kerkon bota nje burr te zot

Se kjo bote s'po gjen derman
Vatra lufte ne cdo an
S'tregojn hallin ku e kan
Me varre mbushur dynjan

Mendoj shkaku pasurija
Qe vriten cdo dit njerzija
Ne gjunje ulet qeverija
Dhe lulezon harbuterija

C'far do hedhi ate do pres
Qejfi kur te mos i mbes
Qe te kete ne jete sukses
Ti bej punet pa pertes

Qe kur lind dhe gjer sa vdes
Njeriu cdo dite rron me shpres
Sa her hape syte ne menjgjes
Hedh shikimin mbi univers

Se kjo jete do mar shtruar
Se si ke ti gjerat ne duar
Qe te jesh gjithmon I fituar
Duhet te jesh I duruar

Hipokrit nuk behem dot
C'kam qen dije jam dhe sot
Keshtu them te mbes dhe mot
Sa te iki fare nga kjo bot

Ata qe nderrojne lekuren
E nderrojn vetem per vulen
Per nje veze te marin pulen
Per interes te pine dhe shuren

Ne do te shkoj puna mbar
Rri I ndershem dhe namusqar
Kurr mos u beje ziliqar
Keshtu kan then njerzit e par

Mushka thot kam dajo kalin
Dhe mohon baba gomarin
Ne kuris e mban samarin
Si babji sjell dru per zjarin

Pse kjo mushka mendje leht
Kurr mohon babajin e vet
Qe rugeve cdo dite pellet
U thot njerzeve une jam mbret

Mushka vijet ne siklet
Dhe ashtu me marifet
Me shaka e me lezet
Kerkon te ulet ne qoshet

Punet e teperta te japin lodhjen
Dashurija te jep vetem cplodhjen
Vec rinija te jep bluarjen
Moshe e madhe te jep ngordhjen

Dy te parat jane me vler
Jane si mjalti me sheqer
E treta te ben qeder
Ta ben zemren vrer e zeher

Jeta eshte humbje dhe fitim
Ka ne mese dhe zhgenjim
Te gjitha arihen me perkushtim
Vetem vdekja eshte asgjesim

Cu terbua I shkreti djal
Kur vuri koken mbi shal
I van djerset pale _ pal
Sikur priste dru ne mal

E terboj nje ere e fort
Nga zgavra dilte e ngroht
Dha e mori s'duroj dot
Dhe ju fute detit me not

Piu shume e su ngop dot
I vajti mundimi kot
Punes tij si doli zot
Zemra dha ndales te plot

Larte ne male qendron shqiponja
Ne eresire ndricon xixellonja
Larte mbi bajga qendron mushkonja
Edhe thote jame me e zonja

Une njerzit I pickoj
Edhe gjakun jua helmoj
Gjurem le ngado qe shkoj
Se jam zonj e permbi zonj

Keto mushkonja llafe shum
Larte mbi baja po flen gjum
Fryu nje ere dhe I coi ne lum
Dhe nuk dolen me mbi kum

Poezija qe eshte pa rim
Si shtepija pa ndricim
Vargu del si me pertim
Dhe catija nuk ka ajrim

Kur ka rime poezija
Llamurin gjith shtepija
Aty ndizet melodija
Tingujt dalin nga catija

Poezija me rime e metafor
Si Mbreteresha me kuror
Nuk ndalon ne semafor
Vetem te pershendet me dor

DASHURI TE NDRYSHME

Dashuri e Angelis per diplomacin
Si dashuri e Frances per lirin

Dashuri e Shqipetareve per besnikrin
Si dashuri e Grekeve per dinakrin

Dashuri e Amerikaneve per politiken
Si dashuri e Italianve per muziken

Dashuri e Japonezve per te punuar
Si dashuri e Kinezve per te kopjuar

Dashuri e Zvicres per tyelet
Si dashuri e Dubajit per gradacelet

Dashuri e Polakeve per votken
Si dashuri e Hollandezeve per lopen

Dashuri e Siberise per dite te ngrohta
Si dashuri e Afrikes per nete te ftoheta

Dashuri e korcareve per serenaten
Si dashuri e Vlonjateve per dekuraten

Dashuri e malsorit per pushken e gjat
Si dashuri e myzeqarit per shat e lopat

Dashuri e tepelenasve per dyfekun
Si dashuri e lushnjareve per dybekun

Dashuri e skrapallinjeve per rakin
Si dashuri e beratesve per ullin

Dashuri e labit per grada dhe ofiqe
Si dashuri e tropojaneve per cifliqe

Dashuri e permetareve per mikpritjen
Si dashuri e shkodraneve per zbavitjen

Dashuri e dursakeve per detin
Si dashuri e matjaneve per mbretin

Dashuri e Gjirokastriteve per te kursyer

Si dashuri e tiranaseve per te kercyer

Dashuri e jugut per verin
Si era qe fryn me suferin

Dashuri e nenes per djaln
Si termeti qe rafshon malin

Dashuri e femijeve per nenen
Si dielli qe ndricon henen

Dashuri e femijve per baban
Si themelet qe mbajn kalan

Dashuri e babait per vajzen e vet
Nuk e shuan as lum as det

Dashuri e babait per jeten e dialit
Eshte si dashuria per syte e ballit

Dashurija per nipper e mbesa
Si bari I lar nga vesa

Dashuri e motres per vllan
Jan si lotet qe shuajn vullkan

Dashuri e burit per gruan
Si mjalti qe lepin dhe thuan

Dashuri e gruas per burin
Si dashuri e shtizes per flamurin

Dashurija e vellajit per vellan
Trashgimenija ne mes I percan

Dashurija e mashkullit per femren
Eshte si terapija per zemren

Dashurija e femres per mashkullin
Eshte si dielli qe shkrin akullin

Dashuri e plakes per plakun
Si dashuri e zjarit qe ngrohe oxhakun

Dashuri e plakut per plaken
Si hiri qe mbulon vatren

Dashuri e nuses per vjeren
Si dashuri e ujkut per shqeren

Dashuri e kunates per kunaten
Si benzina qe ndes flaken

Dashuri e gruas per te llafosur
Si dashuri e burit per te tymosur

Dashuri e gruas per te gatuar
Si dashuri e burit per te argetuar

Dashuri e gruas per te punuar
Si dashuri e burit per te kenduar

Dashuri e burit per rakin
Si dashuri e gruas per tepsin

Dashurija e poetit per Memedhen
Si dashuri e zogut per folen

Dashurija e mergimtareve per Vatan
Si dashuri e ktolikeve per Vatikan

Dashuri e hoxhes per priftherinj
Si rakija me peshk e ullinj

Dashurija e priftit per hoxhallar
Si vera me biftek te pjekur ne zgar

Dashurija e te semurit per doctor
Eshte bakshishi qe jep nen dor

Dashurija e pranveres per lulet
Si dashuri e dimrit per fasulet

Dashurija e cobanit per delen e dhin
Matet me qumshtin qe mbush kusin

Dashuri e stomakut per te bluar
Si dashuri e dhembeve per te kafshuar

Dashuri e syve per te shikuar
Si dashuri e zemres per te punuar

Dashuri e gojes per te kenduar
Si dashuri e vesheve per te degjuar

Dashuri e supes per krip e piper
Si dashurijja e bkllavas per sheqer

Dashuri e gjelperes per te qepur
Si dashuri e gersheres per te shqepur

Dashuri e malit per deboren
Si dashuri e mbretit per kuroren

Dashuri e fushes per tulipan
Si dashuri e mbretereshes per gjerdan

Dashuri e mbretit per mbretereshen
Si dashuri e luanit per luaneshen

Dashuri e mbretereshes per mbretin
Si dashuri e balenes per detin

Dashuri e malit per te pyllezuar
Si dashuri e fushes per lulezuar

Dashuri e bilbilit per te kenduar
Si dashuri e qyqes per te vajtuar

Dashuri e ariut per te dimeruar
Si dashuri e zoqeve per te shtegtuar

Dashurija e qenit per te ruajtur shtepin
Si dashuri e ujkut per te ngren bagetin

Dashuri e qenit per te kafshuar
Si dashuri e gjarperit per te helmuar

Dashuri e cobanit per blektorin
Si dashuri e qumshtit per kusin

Dashuri e qenit per te zotin
Si dashuri e qorit per shkopin

Dashuri e Henes per Diellin
Si dashuri e yjeve per Qiellin

Dashuri e murit per suvan
Si dashuri e catis per tavan

Dashuri e njeriut per kuletën
Si dashuri e kosheres per bletën

Dashuri e nates per eresiren
Si dashuri e dites per bardhesiren

Dashuri e murit per catin
Si dashuri e portes per avellin

Dashuri e gardhit per lessen
Si dashuri e oborit per fshesen

Dashuri e dimrit per zjarin
Si dashuri e pranveres per lastarin

Dashuri e syrit per lotin
Si dashuri e avjonit per pilotin

Dashuri e yjeve per Qiellin
Si dashuri e dites per Diellin

Dashuri e dashuris per dashurin
Si dashurija ime per Shqiperin

Miqesi e miqesis per miqesin
Kur ti mban hapur gjithmon shtepin

Urejtja e urejtjes per urejtjen
Si urejtja e njeriut per vdekjen

Bujarija e bujaris per bujarin
Kut ti ndihmon gjithmon njerzin

Diturija e dituris per diturin
Kur per diturin ti shete dhe pasurin

Morali I moralit per moralin
Kur le fushen dhe shikon malin

Ideali I I idealit per idealin
Kur vajzen eke nje lloj si djalin

Arsyetimi I arsyetimit per arsyetimin
Si vapa e madhe qe shteron burimin

Te rish zgjuar nate e dite
Nuk kane funde dashurit

S'eshte nevoja tu zesh prit
Se te dalin vet ne drit

Erdhi ora qe ta bitis
Se kam hall mos tju merzis
Fikni dritat e shtepis
Flini gjumin e miresis

PO PRES NIPIN QE UNE DUA

Do ti shkruaj vete dy fjal
Ndricoj hena lart mbi mal
Djali ime po pret nje djal
Po na vjen hipur mbikal

Me del gjumi cdo mengjes
Kam vite qe po e pres
Nipin tim me shum shpres
Ai po vjene serbes- serbes

Fillade pranvere po vjen nga pylli
Ditet shkurti do ti mbylli
Ikin rete dhe do dal ylli
Mjalti do pikoj nga dylli

Nuk ka si gezimi I par
Nipi ime si margaritar
Zemera sec te mer te car
Ndizet flak e ndizet zjar

Gjyshi e gjyshja po e presin
Me te dashurit per ty do mbesim
Sa te rrojm do ta mbeshtesim
Kur te vije ora le te vdesim

O djali I djalit tim
Une dhe Moza me perkushtim
Po te presim me pa durim
Do jesh ilac per sherim

Abetaren ta kame bler
Te mesosh shqipen me vler
Do rim bashke per nga her
Ti degjues dhe une sufler

Amanetet ti kame len
Ato qe dua ti kam then
Fjalet e mija vend le te zen
Me te miren zgjith e ben

Nuk ka si djali I djalit
Uji I kulluar nga bora e malit
Une per te si ndahem mallit
Do ta dua si syte e ballit

Erdhi koha dhe sehati
Po vjen nipi mjalt I mjaltit
Une per te I lutem fatit
Qe ti ngjaj djali te jatit

Brez pas brezi trashgimena
Gjak I kuq nga Shqiperia
Dalin diemte nga vegjelia
Do shkruaj per ta historia

DESHIRAT E MIJA PER NIPIN TIM

Une sote po perjetoj castet me te lumtura te jetes time . Jame duke pritur ardhjen ne jete te nipit tim te dashur. Ashtu si thone prinderit tan qe femija I femijes eshte mjalti I mjaltit. Edhe une sot po pres me pa durim qe ky mjalt te kulloje nga qielli e te zbres ne duart e nenes dhe te babes se vete. TI o nipi im I dashur po vine ne jete ne nje vende te begat,ne nje vende madheshtor. Ne nje vend qe ka shkelqim ekonomik, ne nje vend qe ka shkelqim lirije, ne nje vend qe ka barazi mendimi dhe shpreje. Ne gjysherit dhe prinderit e tu patem nje fat te mbrekullueshem qe erdhem dhe jetojm ne kete vend te bekuar.Kurse ju qe do lindni ne kete vend do keni privilegje akoma me shum se nga ne te ardhurit nga vendet e tjera shume te largeta. Ne kete vend te nderuar endrat behen realitet.Edhe une ne kete leter qe do ta le ne forem amaneti do te paraqes enderat dhe deshirat e mija qe kam per ty o nipi im I dashur.Sipas tradites se bukur te ketij vendi te nderuar sote ne kete Bebishahur te organizuar per ju jan mbledhur shum njerz nga miqesia e shoqerija dhe nga familja jote te te japin dhurata te ndryshme sipas deshirave te vet atyre. Kurse une si gjyshi jote vije ketu me nje

dhurat disi te vecant, me nje dhurat me pak vlera ekonomike, por me vlera shum te pasura ,ideore, morale, me shum deshira dhe endera qe une kerkoj qe te plotesohen nga ana juaj si nipi ime I par ne jeten time. Dhurata e pare sic da shikosh kure te ritesh eshte nje Enciklopedi Boterore me njerzit me te shquar ne historin e kesaj toke. Duke patur fatin e madh qe ju lindet ne kete vende te mbrekullueshem une deshiroje qe ju o nipi ime I dashur te shfrytezoni te gjitha te mirat e ketij vendi, duke filluar qe nga arsimi,shkenca dhe teknologjia ,ti shfrytezoni ato dhe ne te ardhmen te plotesoni nje nga deshirat dhe enderat e mija qe dhe emeri juaj dhe mbiemeril prindeve te tu dhe te gjysherve dhe te ter brezave para aredhes te shkruhet ne kete liber te ralle te historis boterore.Deshiroj qe kjo te arrijet dhe profecija ime te realizohet. Gjithashtu si nenshtetas I lindur ne Amerike ke privilegjin te gezosh te mirat e ketij vendi, por nga ana tjeter ked he detyrime ndaj ketij vendi. Se pari ti duhesh te betohesh perpara flamurit se do te punosh e luftosh per te mbrojtur kete vend te shenjte.Kjo eshte dhe arsya qe ne listen e dhuratave nga ana ime eshte dhe flamuri Amerikan me 50 yjje qe nuk I ka as nje vende ne bote. Eshte nje flamur qe perfaqeson universin. Dhurata tjeter qe te kame prur o nipi im I mirepritur eshte

njeAbetare ne gjuhen shqipe. Une nuk do ti mbyll syte po nuk te mesova gjuhen shqipe,gjuhen e nenes tende , gjuhen e te pareve te tu.Gjuha shqipe eshte nje nga gjuhete e vjetra ne Europe, eshte folur qe nga Orakulli I Dodones dhe eshte cilesuar si gjuhe e zogjeve nga vete Homeri I lashtesis.

Amaneti ime eshte qe ju ta duani Shqiperine, atdheun e te pareve te tu. Te mendosh per Shqiperin dhe Shqiptaret dhe ti ndimosh me te gjith mundesite qe mund te te jepen. Te behesh me te vertet nje Shqiptar patriot, se patriotet me te medhenj shqiptar kan punuar dhe jetuar jashte atdheut. Si dhurat e katert I dashur nipi ime eshte dhe Flamuri Shqipetar si symbol Patrijotizmit dhe I atdhedashuris,ku para ketij flamuri jan betuar njerzit me te shquar te luftes dhe te lirise,te pushkes dhe te penes ne gjithe historin legjendare te vendit te te pareve te tu. Flamuri shqipetar ka ne qender te tije simbolin me te vjeterne histori. Ka shqiponjen qe fluturon ne lartesite me te larta,qe eshte cilesuar si shpend I diellit.kjo shqiponje krenare me dy koka qe nenkupton shikimin e saj nga lindja ne perendim. Edhe ky flamur ka patur dikur nje yll me pes cepa qe sot nuk e ka me, por vlera,krenarija ,madheshtija si dhe ngjyra e kuqe qe tregon gjakun e derdhur ne luften per lirin e popullit te vet,I japin vlera te pa

llogaritsheme ketij flamuri, qe nuk eshte perulur as nje her ne historin e tij. Kerkoj nga ty I dashur nipi im qe ta duash ta nderosh e ta mbrosh kete flamur se eshte historia dhe krenarija e te pareve te tu. Keto ishin deshirat dhe amanetet e mija per ju I dashur nipi im. Duke u nisur nga geni I gjakut tend qe eshte nje vazhdimesi e prinderve te tu dhe e te pareve te tu kam besimin se cdo gje do me realizohet. Duke perfunduar kete leter ne forem testament qe ti do ta lezosh kur te kesh mesuar shqipen e bukur dhe kur tit e jesh ritur dhe une ndoshta nuk do te jem me do me kujtosh dhe do mobilizohesh me shume per te zbatuar deshirat e gjyshit tend. Po te pres me pa durim qe te takohem me ty o nipi im I dashur.

CHIKAGO ~ 12 – I - 2019

PASQYRA E LENDES ----- FAQE

1 – VEGJELIA -----	3
2 – BESA E SHQIPTARIT -----	16
3 – PATRIJOTET -----	20
4 – PER FLORIRIN -----	26
5 – XHELOZIJA -----	31
6 – VDEKJA -----	37
7 – MBRETI DHE POETI -----	41
8 – VETERANET E LUFTES -----	47
9 – PER BALLISTA E NEOBALLISTA -----	49
10 – MITAT FRASHERI -----	62
11 – PER EDI RAMEN -----	66
12 – RILINDJA E PS -----	71
13 – FAIK KONICA -----	77
14 – THEOFAN STILIAN NOLI -----	83
15 – EDIT DURHANI -----	87
16 – DHESPOTIT ILIA KETRI -----	90

17 – LETRA E DYTE PER NENEN -----	92
18 - DIKTATURA E KADARES -----	98
19 – ISMAILI I DEMOKRACIS -----	101
20 – CIZE ARIFI XHAXHAI IM -----	106
21 - ATA QE NUK VDESIN KUR -----	109
22 – QENI BESNIK -----	115
23 - KURBETI -----	118
23 – VAJZE E VALEVE -----	121
24 – PLEQERISHTE -----	124
25 – JETA IME -----	134
26 – EPIGRAME -----	149
27 – TRIPTIKA -----	157
28 – DASHURI TE NDRYSHME -----	163
29 – PO PRES NIPIN QE UNE DUA -----	172
30 - DESHIRAT E MIJA PER NIPIN TIM -----	174